



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENSIA E SHEBIMEVE PUBLIKE
BASHKIA BERAT

Nr. _____ Prot.

Berat më ____ .08.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: *“Blerje pjesë këmbimi dhe shërbime për mjetet e Transportit.*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 3433000-9

Vlera e fondit limit për njësi: **5,087,861 Lek (Pesë Milion e tetëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e qjashtëdhjetë e një) lek pa Tvsh.**

Vlera e pritshme e kontratës: **5,087,861 Lek (Pesë Milion e tetëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e qjashtëdhjetë e një) lek pa Tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Shërbimeve Publike ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1.KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENSIA E SHEBIMEVE PUBLIKE

BASHKIA BERAT

- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërket për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENSIA E SHEBIMEVE PUBLIKE

BASHKIA BERAT

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfasuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas **Shtojcës 3 të DST;**

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas **shtojcës 9 të DST;**

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar ofertuesit duhet të paraqesin:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022, 2023, 2024**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojë dhe aftësi zbatuese në lidhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se vlera e fondit limit. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENSIA E SHEBIMEVE PUBLIKE

BASHKIA BERAT

e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2.2. Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të tre viteve të fundit **2022, 2023, 2024**, të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivit .

“Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, janë vendosur kriteret e mësipërme, për të vërtetuar se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën me sukses.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **2022,2023,2024**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës,** ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/ dhe fatura tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

ose

- b) Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat,** si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara dhe të jenë të deklaruar në organet tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, neni 55 pika 4 germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENSIA E SHEBIMEVE PUBLIKE

BASHKIA BERAT

vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë personelin e nevojshëm për realizimin e kontratës, në përbërje të të cilit të ketë minimalisht 3 (tre) punonjës sipas profileve të mëposhtme:

- 1 (një) motorrist
- 1 (nje) xhenerik
- 1 (nje) saldator

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqiten kontratat individuale të punës.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton stafin teknik , do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara publikimi te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatave te ankimit.

Argumentimi: Nëbazëtepikës 4, tënenittë 77, tëligjitnr. 162, datë 23.12.2020 “Përprokuriminpublik” dhenenit 41, pika 4/ b)dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Përmiratimin e RregullavetëProkurimitPublik”, me anëtekëtijkriterikërkohetqëoperatorët e konomikëtëdëshmojnëqëkanëstafin, personelin e nevojshëmtëkualifikuarpërrealizimin me suksëstëkontratës.Konkretisht: Referuar natyres se shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic jane riparime dhe mirmbajtje të agregatit të motorrit, të karrocërise, te sistemeve drejtimit, frenimit, kondicionimit, amortizimit , saldime te ndryshme etj eshte e nevojshme pasja e nje stafi teknik me profesione si motorrist, xhenerikë, ,saldator e vertetuar kjo ne baze te kontratave te punës si dhe të deklaratës se plotësuar nga operatori ekonomik me qellim realizimin me suksëstëkontrates. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të deklarojë që disponon një servis në pronësi ose me qera brenda Territorit të Bashkisë Berat gjatë periudhës së ekzekutimit të kontratës. Kur servisi është në pronësi operatori ekonomik duhet të paraqesi certifikatën e pronësisë dhe kartelën e pasurisë. Në rastin e disponimit të servisit me qira të paraqitet kontrata noteriale e qirasë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion ambjentin, mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.Nisur nga fakti se shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, te cilat duhet te dërgohen ne ambjentet e servisit të përcaktuar nga



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENSIA E SHEBIMEVE PUBLIKE

BASHKIA BERAT

autoriteti kontraktor është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) ambient ku ushtron aktivitetin e tij me qëllim realizimin te objektit te prokurimit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të japi garanci për punën e kryer deri në 6 muaj.

Argumentimi: *Me anë të kësaj deklarate synohet që mallrat që do të dorëzohen të jenë të reja dhe me garanci dhe që fituesi i procedurës së prokurimit gjatë kësaj periudhe të garantojë për autoritetin kontraktor të përfshirë në këtë procedurë, riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbim pa pagesë konform specifikimeve teknike sa herë të lind nevoja.*

2.3.5. Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë liçensën VII.3 .B.1 “Autoriparimi i mjeteve me motor dhe rimorkiove per kater pikat a,b,c,ç”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4 , gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të i Transportit dhe Infrastrukturës Nr.1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë te punësuar në stafin e tij, të paktën:

-1 (një) Inxhinier mekanik/ teknik/ mekanik transporti, në detyrën/rolin e drejtuesit teknik.

Për punonjësin e drejtuesit teknik, OE duhet të paraqesi diplomë perkatëse si dhe kontratën e punës ku te jete përcaktuar roli i tij si drejtues teknik.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton stafin teknik , do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara publikimi te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatave te ankimit.

Argumentimi: Nëbazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENSIA E SHEBIMEVE PUBLIKE

BASHKIA BERAT

anë të këtyre kriterit që kohët e kaluara operatorë ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Autoriteti Kontraktori kërkon që kontraktuesi duhet të ketë një drejtues teknik për kryerjen e shërbimeve cilikanë një rreth të rëndësishëm në mënyrë vajtjen e punimeve pasi ata janë të përgjegjës për zbatimin e objektit dhe në përputhje me kushtet teknik të zbatimit të tij. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e veçantë për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë pune e vlefshme, diploma etj. janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se ky person përgjegjës është operativ pranë Ofertuesit të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktori krijon bindjen se Operatorë ekonomikë pjesëmarrës të tjerë në personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktori kërkon që operatorë ekonomikë ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjëste aftësi profesionale për realizimin e objektit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike dhe fondi limit janë percaktuar nga komisionet e ngritur me Urdhërat e brendshëm.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJESIA E PROKURIMIT

Roland Deda

Brikena Halitaj

Roland Sinjari

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Joana Melengu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENSIA E SHEBIMEVE PUBLIKE
BASHKIA BERAT